



Republika e Kosovës
Ministria e Arsimit, e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministry of Education, Science and Technology
Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë
Departman, Nauke i Tehnologje
Department of Science and Technology

LIBRI I ABSTRAKTEVE

nga konferenca 'Java e Shkencës' 2014



JAVA E SHKENCËS
SCIENCE WEEK

Prishtinë - Prishtinë
13, 14, 15 dhe 16 maj 2014
13, 14, 15 and 16 of May 2014

Prishtinë
13, 14, 15 dhe 16 maj 2014

LIBRI I ABSTRAKTEVE
NGA KONFERENCA VJETORE E SHKENCËS “JAVA E SHKENCËS
2014”

Redaktimin teknik, kopertinat dhe radhitjen kompjuterike:
Murteza OSDAUTAJ
logo® Burim GASHI

Abstraktet botohen ashtu siç janë dorëzuar nga autorët e tyre. Janë bërë vetëm shkurtime të domosdoshme për ta ruajtur maksimumin prej 150 fjalësh për një abstrakt. Radhitja është bërë sipas rendit alfabetik.



Ministria e Arsimit e Shkencës dhe e Teknologjisë
Ministarstvo Obrazovanja, Nauke i Tehnologije
Ministri of Education, Science and Technology
Departamenti i Shkencës dhe Teknologjisë
Departament za Nauku i Tehnologiju
Department for Science and Technology

LIBRI I ABSTRAKTEVE

KONFERENCA E GJASHTË VJETORE E SHKENCËS “JAVA E SHKENCËS 2014”

Prishtinë
2014

Blerim Rexha, Ehat Qerimi, Ramadan Dervishi, Vehbi Neziri. ANONIMITETI DHE PRIVATËSIA NË APLIKACIONET BASHKËKOHORE DUKE PËRDORUR eID

Fakulteti i Inxhinierisë Elektrike dhe Kompjuterike, Universiteti i Prishtinës
Prishtinë, REPUBLIKA E KOSOVËS

Abstrakti.

Krijimi i aplikacioneve bashkëkohore softuerike të ndryshme për desktop, ueb apo mobile nuk është ndonjë sfidë e madhe pasi që në treg tashmë ekzistojnë vegla me të cilat këto aplikacione mund të ndërtohen dhe përdoren lehtë. Sfidë më e madhe për këto lloj aplikacionesh është rritja e sigurisë dhe privatësisë së përdoruesit gjatë përdorimit të këtyre aplikacioneve.

Pasi që një numër i madh i shteteve kanë filluar të prodhojnë kartat elektronike ose eID (Electronic ID), atëherë shfrytëzimi i kësaj teknologjie si çelës i sigurt për qasje në aplikacione do të ishte një përparësi. Kjo teknologji do të mund të zbatohet në shumë shërbime e sidomos në ato ku kërkohet që të mbrohen grup-mosha të caktuara, duke kërkuar paraprakisht autentikimin dhe autorizimin, por edhe duke ruajtur privatësinë. Në këtë rast përdoruesi do të mbetet anonim kundrejt aplikacionit apo shërbimit, e gjithashtu mund të mbetet anonim edhe veprimi i tij. Ky lloj i pseudo-anonimitetit do të mund të realizohet duke përdorur pseudo certifikatën e cila ndodhet në eID kartelë.

Fjalët çelës: privatësia, siguria, pseudo-certifikatë, pseudo-anonim, eID, autentikim.